



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KRYETARI

PROJEKT-VENDIM

Nr. 01 Date 25/03/2024

**“PËR RISHIKIMIN DHE PËRDITËSIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË
BASHKISË DIBËR”**

Mbështetur në nenet 15, 18 pika 3, 54 shkronja “k”, të ligjit nr 139/2015 datë 17.02.2015 ” Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjin nr.119/2014” Për të drejtën e informimit, Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.143, datë 24.12.2018, “ Për miratimin e Programit të Transparencës së Bashkisë Dibër”, Kryetari i Bashkisë, ju paraqet projektin përkatës:

Për të vendosur:

1. Miratimin e rishikimit të Programit të Transparencës të Bashkisë Dibër sipas lidhjes bashkangjitur.
2. Kryetari i Bashkisë është përgjegjës për përditësimin dhe zbatimin e Programit të Transparencës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga Prefekti i Qarkut Dibër.

Koordinatorë për të drejtën e informimit


Donjila Shehi

Drejtor i Drejtorisë Juridike

Ismet Saraçi

KRYETARI I BASHKISË

Rahim SPAHIU



Adresa: Bulevardi “ELEZ ISUFI”, Peshkopi, email: bashkiadiber@gmail.com nr.tel:0035521822935



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KRYETARI

Peshkopi, më ___/___/2024

RELACION

Për rishikimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Dibër

Të nderuar këshilltarë!

Në zbatim të përgjegjësiave të Bashkisë Dibër në garantimin e transparencës së veprimtarisë së saj, parashikuar nga nenin 15 i ligjit nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", mbështetur edhe në modelin e programit të transparencës miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me urdhër nr. 211, datë 10.09.2018, Këshilli i Bashkisë Dibër, me vendim nr.143, datë 24.12.2018, ka miratuar Programin e Transparencës të Bashkisë Dibër.

Për tu garantuar qytetarëve sa më shumë transparencë, llogaridhënie, akses në qeverisje dhe kushtet e duhura për të ushtruar të drejtat e tyre qytetare, për ti informuar mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë, menaxhimin financiar, trajtimin e kërkesave për informacion, shërbimet publike që ofrohen dhe pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje, është parë e nevojshme rishikimi dhe përditësimi i Programit të Transparencës siç edhe parashikohet në nenin 5 të ligjit nr 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar ku citohet: "*Rishikimi i programit të transparencës, bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës bëhet miratimi. Afatet për rishikimin e programit të transparencës mund të ndryshojnë në varësi të natyrës së çdo autoriteti publik, por në asnjë rast nuk mund të jenë më të gjata se 5 vjet.*

Rishikimi dhe përditësimi i Programit të Transparencës, do të bëjë që informacioni i publikuar të jetë i aksesueshëm dhe lehtësisht i kuptueshëm nga individët dhe grupe të ndryshme të shoqërisë, duke respektuar kufizimet e arsyeshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë.

Nëpërmjet rishikimit dhe përditësimit të Programit të Transparencës, Bashkia Dibër vendos në dispozicion të qytetarëve një kategori të gjerë informacionesh, mënyrat dhe afatet e publikimit të tyre si dhe procedurat për të aksesuar e përdorur ato.

Në rishikimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës, Bashkia Dibër është bazuar në parimin e :

- a) **Vendosjes në dispozicion të çdo qytetari**, të të gjithë informacionit të prodhuar nga veprimtaria e bashkisë .
- b) **Ligjshmërisë, transparencës dhe të mos diskriminimit.**
- c) **Ofrimit të informacionit pa pagesë.** Informacioni i kërkuar në rrugë elektronike i jepet çdo qytetari pa pagesë. Çdo qytetar përfiton informacion pa pagesë deri në ...faqe, mbi këtë numër faqesh qytetari paguan një tarifë shërbimi prej...lekësh.
- d) **Aksesit për këdo.** Aksesit për shtresat më të varfra të komunitetit, qytetarët me aftësi të kufizuar, gratë, të rinjtë, biznesin, fermerët, qytetarët e zonave të largëta etj.
- e) **Thjeshtëzimit të procedurave** administrative për aksesin në informacion.
- f) **Dhënies së informacionit sa më shpejtë që të jetë e mundur.**
- g) **Cilësisë së informacionit**, i cili duhet të jetë: i plotë, i saktë; i përditësuar; i thjeshtë; i kuptueshëm; lehtësisht i aksesueshëm; i pajtueshëm me dokumentet origjinale në administrim të bashkisë dhe lehtësisht i përdorshëm.

Për t'i bërë më të thjeshtë, të kuptueshëm, të aksesueshëm dhe të përdorshëm kategoritë e informacionit, të parashikuar shprehimisht në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" (në vijim ligji), janë përshtatur me kontekstin e vetëqeverisjes vendore; me misionin, detyrat, funksionet dhe kompetencat e bashkisë dhe të ndara në 7 fusha kryesore:

Fusha e parë: *Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë*, përfshin kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë të përcaktuar nga neni 7 (pika: a; d; g; ç, dh) i ligjit. Kjo fushë iu ofron qytetarëve informacion për ndarjen administrativo-territoriale, njësitë administrative përkatëse dhe nën-ndarjet e tyre, për misionin dhe funksionet e bashkisë, për organet e zgjedhura, për administratën e bashkisë, për statistikën vendore, për mekanizmat monitorues dhe të kontrollit si dhe për të drejtën e kërkesës, ankesave dhe vërejtjeve të qytetarëve që lidhen me veprimet ose mosveprimet e organeve dhe administratës së bashkisë.

Fusha e dytë: *Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare*, përfshin kategoritë e informacionit të përcaktuar nga neni 7 (pika: dh; e; ë) i ligjit. Këto kategori informacioni janë përshtatur me kërkesat e ligjit Nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore". Në këtë fushë përfshihen informacione që kanë të bëjnë me planin strategjik të zhvillimit të bashkisë, me programin buxhetor afatmesëm vendor, me paketën fiskale (taksa dhe tarifa), me buxhetin vjetor, me zbatimin, monitorimin, mbikëqyrjen dhe auditimin e buxhetit, me donacionet si dhe shitjen ose dhënien me qira të pronave dhe asetëve.

Fusha e tretë: *Për kërkesat për informim*, përfshin vendosjen në dispozicion të qytetarëve të informacionit që ka të bëjë me procesin, procedurat, format dhe afatet e kërkesës për informim. Përmbledhja e katër kategorive të informacionit të përcaktuar në nenin 7 (pika c; ç; i; dhe k) të ligjit, në një fushë të vetme, lehtëson aksesin e qytetarëve për këto kategori

informacioni, i orienton dhe udhëzon ato se si mund të bëjnë një kërkesë për informim.

Fusha e katërt: *Mbi shërbimet që ofron bashkia*, përfshin informacion mbi shërbimet që ofron bashkia të përcaktuara në nenin 7 (pika: f; j, ë dhe pjesërisht pika a) të ligjit.

Nëpërmjet kësaj fushe vihet në dispozicion të qytetarëve informacioni mbi shërbimet publike që ofron bashkia, llojet e shërbimeve, instrumentet e administrimit, kontratat publike, strukturat përgjegjëse, procedurën e ankimit në lidhje me kontratat publike, standardet, treguesit, procedurat për të përfituar shërbime si dhe procedurat e ankesës dhe vërejtjes në lidhje me shërbimet.

Fusha e pestë: *Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore*, informacion i përcaktuar në nenin 7, pika b të ligjit. Kjo fushë u ofron qytetarëve informacion për legjislacionin, politikën, vendimet, urdhëresat dhe urdhrat karakter normativ të organeve të bashkisë. Për të lehtësuar qasjen në informacion, fusha e legjislacionit është ndarë sipas funksioneve.

Fusha e gjashtë: *Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje*, përfshin informacion në lidhje me procesin, procedurat, kuadrin rregullator vendor, listën e akteve vendore që i nënshtrohen konsultimit publik dhe nismat qytetare.

Fusha e shtatë: *Informacion tjetër*, bashkia vë në dispozicion të qytetarëve informacion të ndryshëm të tillë si proceset e integritetit evropian (programet dhe projektet); shoqëria civile; raporte, studime dhe vlerësime të ndryshme, veçanërisht ato në lidhje me vlerësimin e transparencës etj; vet-organizimi komunitar etj.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, ju ftoj në miratimin e projekt aktit!

KRYETARI I BASHKISË

Rahim SPAHIU



**I. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENÇES
BASHKIA DIBËR**

Fusha 1 - Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë

Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Referenca ligjore	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin
1.	<p>Organizimi administrativo-territorial, misioni dhe funksionet. Bashkia bën publike:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ndarjen administrative-territoriale <ul style="list-style-type: none"> - Njësitë administrative dhe nën-ndarjet e tyre 2. Të drejtat, përgjegjësitë dhe misionin e bashkisë. 3. Funksionet <ul style="list-style-type: none"> - Përfaqsimin bëjnë publike të: <ul style="list-style-type: none"> • Funksioneve në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike; të shërbimeve sociale; e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese; e mbrojtjes së mjedisit; e bujqësisë, zhvillimit rural, pyetjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit; e zhvillimit ekonomik vendor. • Funksionet dhe kompetencat e deleguara 	<p>Neni 7 i ligjit nr.119/2014</p> <p>Ligji nr.115/2014</p> <p>Neni 23-30 i ligjit nr.139/2015</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/organizimi dhe http://dibra.gov.al/organizimi-i-bashkise/organizimi-admin-territorial/misionifunksionet/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>Menjëherë</p>	<p>Sipas akteve ligjore dhe nëligjore në fuqi</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>
2.	<p>Organi përfaqësues i bashkisë-Këshilli i Bashkisë</p> <p>Përfaqsimin bëjnë publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Anëtarëve, Kryetarit të Këshillit, Sekretarit të Këshillit, Komisioneve, Grupeve të keshilltarëve • Detyrave dhe kompetencave • Rregullores së Këshillit Bashkiak 	<p>Neni 7 i ligjit nr.119/2014</p> <p>Ligji nr.139/2015</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/organizimi-i-bashkise/organizimi-perfaqesues-i-bashkise-keshilli-bashkiak/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>Menjëherë</p> <p>Vendimet brenda 10 ditëve nga data e miratimit</p>	<p>Këshilli i Bashkisë</p> <p>Thirrja e mbledhjes - Kryetari i KB</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p> <p>Sekretari i Këshillit të Bashkisë</p>

<p>3. Organi përfaqësues i bashkisë – Këshilli i Bashkisë</p> <p>Përfshin bëjten publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kalendarit, njoftimeve dhe rendit të ditës të mbledhjeve të KB • Projekt-vendimet në proces shqyrtimi nga KB • Procesverbalet e mbledhjeve të KB • Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat me karakter normativ 		<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/organizimi-dhe-funksionimi-i-bashkise/organi-perfaqesues-i-bashkise-keshilli-bashkiak/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>		<p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>
<p>4. Organi ekzekutiv – Kryetari Bashkisë</p> <p>Përfshin bëjten publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Procedurave të zgjedhjes, detyrat dhe kompetencat, të dhënat për arsimin, kualifikimet, paga kryetarit dhe deklarami i pasurisë • Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat me karakter normativ • Orari i prirjes së qytetarëve • Adresa postare/ elektronike 		<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/organizimi-dhe-funksionimi-i-bashkise/organel-e-bashkise/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>		<p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>
<p>5. Administrrata e bashkisë.</p> <p>Përfshin bëjten publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Strukturës organizative dhe numrin e punonjësve • Rregullores së organizimit dhe funksionimit të administratës • Strukturës së pagave • Orarit të punës së bashkisë, njësive administrative dhe njësive të varësishë • Detyrave të administratës së njësive administrative • Organizimit dhe funksionimit të njësive në varësi • Njoftimeve mbi vendet e lira pune dhe procedurat e rekrutimit • Adresave postare dhe elektronike e zyrave të bashkisë/njësive administrative/njësive në varësi • Drejtuesit e zyrave, njësive administrative dhe njësive të varësishë 	<p>Neni 7 i ligjit nr.119/2014</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/organizimi-dhe-funksionimi-i-bashkise/administrata-e-bashkise/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>Menjëherë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>

6	<p>Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit.</p> <p>Përshin bëjten publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> Kartës dhe Kodit të Etikës së Auditimit të Brendshëm Planit strategjik dhe vjetor si dhe çdo raporti të auditimit të brendshëm të ushtruar në bashki Çdo raporti përfundimtar të kontrollit të jashtëm (KLSH) të ushtruar në bashki Planit të veprimi për zbatimin e rekomandimeve të tjera në përfundim të procedurave të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm 	<p>Neni 4/3/3 i ligjit Nr. 139/2015, neni 7/dh, i ligjit nr. 119/2014 si dhe neni 8/c dhe neni 12/ç dhe d, i ligjit nr. 114/2015</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/organizimi-dhe-funksionimi-i-bashkise/mekanizmat-monitorues-dhe-te-kontrollit/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>Brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të raportit përfundimtar</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>
7	<p>Kërkesa, ankesa, sinjalizime dhe vërejtje që lidhen me veprimet ose mosveprimet e organeve dhe administratës. Përshin bëjten publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> Procedurave për të bërë kërkesë, ankesë, vërejtje dhe sinjalizime organeve të bashkisë Rregullores së brendshme për procedurën e shqyrtimit, të hetimit administrativ, të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit Njësisë përgjegjëse që regjistrojnë, hetojnë administrativisht dhe shqyrtojnë sinjalizimet Adresave postare/elektronike për depozitimin e kërkesave, ankesave, sinjalizimeve apo vërejtjeve Afateve dhe mënyrave të kërkimit të përgjigjeve 	<p>Neni 7 i ligjit nr. 119/2014 Neni 19 i ligjit nr. 139/2015 Neni 10 dhe 13, të ligjit nr. 60/2016</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/organizimi-dhe-funksionimi-i-bashkise/procedurat-e-berjes-se-kerkesave-ankesave-dhe-verejtjeve/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>Menjëherë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>
8.	<p>Statistikat vendore.</p> <p>Përshin bëjten publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> Kalendarit të publikimit të statistikave vendore Statistikave vendore me të dhëna kyçe të Bashkisë sipas fushave kryesore dhe të ndara sipas gjinisë Strukturës përgjegjëse në bashki për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave vendore 	<p>Neni 64/1 i ligjit nr. 139/2015</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/organizimi-dhe-funksionimi-i-bashkise/statistika-vendore/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>Menjëherë pas miratimit</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>

Fusha 2 - Transparenca dhe Llogaridhënia Ekonomiko-Financiare

Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Referenca ligjore	Mënyra e bëjtes publike së këty informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin
-----	---	-------------------	--	--------------------------	-----------------	----------------------------------

1.	<p>Kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe të buxheit vjetor</p>	<p>Neni 33 i ligjit nr.68/2017 dhe neni 18 i ligjit nr.139/2015</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparenca-dhe-llogaridhenia-ekonomikofinanciare/kalendari-i-prg-buxhetor-afatmesemvjetor/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>Në 10 ditëshim e parë të janarit</p>	<p>Këshilli i Bashkisë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>
2.	<p>Paketa fiskale (taksa dhe tarifa). Përshin bërgen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bazës dhe niveli të taksave dhe tarifave • Përfashimeve dhe lehtësimeve të subjekteve të caktuara • Afateve të pagesave • Gjohave dhe kamatëvonesave të aplikueshme 	<p>Neni 5/b dhe 12 të ligjit nr.68/2017</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparenca-dhe-llogaridhenia-ekonomikofinanciare/paketa-fiskale/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>Brenda 15 ditëve nga miratimi</p>	<p>Këshilli i Bashkisë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>
3.	<p>Plani Strategjik i Zhvillimit të bashkisë. Përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politikat për zhvillimin e qëndrueshëm në një afat kohor jo më pak se 5 vite • Symmet kryesore për çdo fushë përgjegjësi • Veprimet që duhen ndërmarrë duke parashikuar edhe kostot përkatëse • Burimet e financimit 	<p>Neni 32 të ligjit nr.68/2017</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparenca-dhe-llogaridhenia-ekonomikofinanciare/plani-strategjik-i-zhvillimit-te-bashkise/</p>	<p>10 ditë nga data e miratimit</p>	<p>Këshilli i Bashkisë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>
4.	<p>Programi buxhetor afatmesëm vendor. Përshin bërgen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dokumentit të parë të programit buxhetor • Dokumentit të rishikuar të programit buxhetor afatmesëm • Dokumentit të plotë të programit buxhetor afatmesëm (përfshirë dokumentacionin shoqërues) dhe informacionit për dy vitet e fundit, vitin buxhetor dhe tre vitet vijuese për çdo program (5 dokumentat përkatës) 	<p>Nenet 36/4, 36/9, 38/2, dhe 39 të ligjit nr.68/2017</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparenca-dhe-llogaridhenia-ekonomikofinanciare/programi-buxhetor-afatmesem-vendor/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>Dokumentit i parë brenda datës 5 korrik.</p> <p>Dokumentit i rishikuar.</p> <p>Dokumentit i plotë jo më vonë se data 31 dhjetor.</p>	<p>Këshilli i Bashkisë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>

<p>5. Buxheti. Përshin bërgjen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> Buxheti vjetor së bashku me dokumentacionin shogërues të tij (12 dokumenta përkatës) Treguesve financiarë Numrit të punonjësve buxhetorë, për çdo njësi shpenzuese Regjistrin të parashikimeve të prokurimit publik 	<p>Neni 41/6 dhe 54 i ligjit nr.68/2017</p> <p>Neni 41 i Ligjit nr.139/2015</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transpareanca-dhe-llogaridhjenia-ekonomikofinanciare/buxheti-vjetor/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>15 ditë pas miratimit nga Këshilli i Bashkisë.</p> <p>Regjistrin e parashikimeve të prokurimit publik 10 ditë pas miratimit të buxhetit.</p>	<p>Këshilli i Bashkisë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>
<p>6. Zbatimi i buxhetit. Përshin bërgjen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> Raportit mujor (pas datës 30 prill) të çdo viti buxhetor) të përmbledhur mbi ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve (8 raporte) 	<p>Neni 44/4 i ligjit nr.68/2017</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transpareanca-dhe-llogaridhjenia-ekonomikofinanciare/zbatimi-i-buxhetit/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>Jo më vonë se data 10 e muajit pasardhës</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p> <p>Informohet Këshilli i Bashkisë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>
<p>7. Monitorimi dhe mbikëqyrja e buxhetit. Përshin bërgjen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> Raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit (jo më pak se tre raportet katër-mujore) Raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit Raportit të performancës vjetore Pasqyrave financiare vjetore (dokumentacionin bazë dhe shogërues) Informacionit për zbatimin dhe monitorimin e kontratave (punëve publike, mallrave dhe shërbimeve) Regjistrin të realizimeve të procedurave të prokurimit publik 	<p>Neni 48/3, 51 dhe 54 i ligjit nr.68/2017</p> <p>Neni 43 i ligjit nr.139/2015 dhe ligji nr. 96/43, datë 20.11.2006</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transpareanca-dhe-llogaridhjenia-ekonomikofinanciare/monitorimi-mbikëqyrja-dhe-auditimi-i-buxhetit/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>Raportet e monitorimit brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit.</p> <p>Raportit vjetor i konsoliduar brenda muajit qershor të vitit buxhetor pasardhës.</p>	<p>Raportet e monitorimit të zbatimit. Kryetari i Bashkisë (Informohet Këshilli i Bashkisë)</p> <p>Raportit vjetor i konsoliduar miratohet nga këshilli bashkiak.</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>

8.	<p>Veshitësitë financiare.</p> <p>Përfshin bërcjen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> Planit për daljen nga situata e veshitësitë financiare 	Neni 56/4 i ligjit nr.68/2017	Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparenca-dhe-llogaridhënia-ekonomikofinanciare/veshitësitë-financiare/	Brenda 10 nga viti	Këshilli i Bashkisë	Kryetari i Bashkisë			
9	<p>Shitja ose dhënia me qira e pronave dhe aseteve</p> <p>Përfshin bërcjen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> Aseteve dhe pronave të ofruara për shitje ose dhënie me qira Kritereve që duhet të plotësohen 	Neni 19 i ligjit nr.68/2017	Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparenca-dhe-llogaridhënia-ekonomikofinanciare/shitja-ose-dhënia-me-qira-e-pronave-dhe-aseteve/		Kryetari i Bashkisë	Kryetari i Bashkisë			
10	<p>Donacionet.</p> <p>Përfshin bërcjen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> Emrit të donatorit Shumës së donacionit Qëllimit e donacionit 	Neni 20/5 të ligjit nr.68/2017	Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparenca-dhe-llogaridhënia-ekonomikofinanciare/donacionet/ Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë	Kryetari i Bashkisë			
Fusha 3- Për kërkesat për informim									
Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Referenca ligjore	Mënyra e bërcjes publike së këtyri informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin			

<p>1. Të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit (Emri, kontaktet dhe kompetencat)</p> <p>Përshin bëjten publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emri mbiemrit të Koordinatorit • Adresës postare/electronike të tij • Orarit të punës • Detyrave dhe kompetencave të Koordinatorit • Adresës postare/electronike për depozitimin e kërkesave për informim 	<p>Neni 7/ç i ligjit nr. 119/2014 dhe neni 15/3 i ligjit nr. 139/2015</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparenca/koordinatori/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>Menjherë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Koordinatori për të Drejtën e Informimit</p>
<p>2. Standartet dhe procedurat që duhen ndjekur për të bërë kërkesë për informim dhe aksesës.</p> <p>Përshin bëjten publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Procedurës që duhet ndjekur për të bërë një kërkesë për informacion • Adresës postare/electronike për depozitimin e kërkesave për informim • Modelin standard të një kërkesë për informim • Afatëve të marrjes së përgjigjes • Procedurave që duhet ndjekur për të bërë një aksesë për mos dhënie informacioni • Adresës postare/electronike për dërgimin e aksesës për mosdhënie informacioni 	<p>Neni 7 dhe 11/4 i ligjit nr. 119/2014 dhe neni 64/j, i ligjit nr. 139/2015</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/kerkesat-per-informim/standartet-dhe-procedurat-e-kerkesave/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>Brenda 48 orëve prej miratimit të tyre</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Koordinatori për të Drejtën e Informimit</p>
<p>3. Regjistrimi i kërkesave dhe përgjigjeve.</p> <p>Përshin bëjten publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të gjitha kërkesave për informim • Informacionet e dhënë në përgjigje të kërkesave për informim • Perditesimi i regjistrimit 	<p>Neni 7/1 i ligjit nr. 119/2014</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/kerkesat-per-informim/regjistrimi-i-kerkesave-dhe-pergjigjeve/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>Menjherë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Koordinatori për të Drejtën e Informimit</p>
<p>4. Informacioni i dhënë më parë</p>	<p>Neni 9 i ligjit nr. 119/2014</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/kerkesat-per-informim/informacioni-i-dhene-me-pare/</p>	<p>Menjherë</p>	<p>Koordinatori për të Drejtën e Informimit</p>	<p>Koordinatori për të Drejtën e Informimit</p>

5.	<p>Trajtimi i kërkesave për informacion</p> <p>Përshin bërijen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Procedurës së regjistrimit të kërkesës në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve • Aftëve të trajtimit të kërkesës nga ana e administratës së bashkisë • Mënyrave të dhënies së informacionit 	Neni 11, 12 dhe 14 i ligjit nr. 119/2014	Në fagen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/kerkesat-per-informimi/trajtimi-i-kerkesave-per-informacion/	Në vendet e caktuara për njoftim publik Njësiti Administrative		Koordinatori për të Drejtën e Informimit	Koordinatori për të Drejtën e Informimit
6.	<p>Kufizimi i së drejtës së informimit</p> <p>Përshin bërijen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rasteve të kufizimit të së drejtës për informim; 	Neni 17 i ligjit nr. 119/2014	Në fagen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/kerkesat-per-informimi/kufizimi-i-se-drejt-es-per-informimi/	Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësiti Administrative		Koordinatori për të Drejtën e Informimit	Koordinatori për të Drejtën e Informimit
7.	<p>Tarifa për dhënie e informacionin (nëse ka)</p> <p>Përshin bërijen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tarifave • Rregullave për mënyrën e kryerjes së pagesës • Subjekteve që përfitojnë informacion falas 	Neni 13/1, 1 ligjit nr. 119/2014	Në fagen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/kerkesat-per-informimi/tarifa-per-dhënie-e-informacionit/	Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësiti Administrative	Menjherë	Këshilli i Bashkisë	Koordinatori për të Drejtën e Informimit
8.	<p>Informacionet dhe dokumentet që kërkohen shpesh.</p> <p>Përshin bërijen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gjithë informacioneve dhe dokumenteve të kërkuara më shpesh nga publiku me kërkesë për informim 	Neni 7/k, 1 ligjit nr. 19/2014	Në fagen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/kerkesat-per-informimi/informacione-dhe-dokumente-ge-kerkohen-shpesh/	Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësiti Administrative	Menjherë	Koordinatori për të Drejtën e Informimit	Koordinatori për të Drejtën e Informimit

Fusha 4 - Mbi shërbimet që ofron bashkia

Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Referenca ligjore	Mënyra e bërijes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin
-----	---	-------------------	--	--------------------------	-----------------	----------------------------------

1.	<p>Shërbimet</p> <p>Përfshin bëjten publike të shërbimeve publike që ofron bashkia në fushën e:</p> <ul style="list-style-type: none"> • infrastrukturës dhe shërbimeve publike; të shërbimeve sociale; të kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese; të mbrojtjes së mjedisit; e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit; të zhvillimit ekonomik vendor dhe sigurisë publike • funksioneve dhe kompetencave të deleguara... <p>Për çdo shërbim (por pa u kufizuar) informacion përshtrohet mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Instrumentin për administrimin e shërbimit • Sistemin e administrimit të performancës së shërbimit bazuar mbi standardet • Sistemin e treguesve, përfshirë edhe aspektin gjinor për matjen e performancës • Strukturën përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës së shërbimit, përfshirë edhe aspektin gjinor 	Neni 32-33, i ligjit nr. 139/2015	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transpareanca/vendi-me-te-keshillit-bashkiak-diber/sherbimet/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë	Kordinatori për të Drejtën e Informimit
2.	<p>Shërbimet administrative</p> <p>Përfshin bëjten publike të shërbimeve publike që ofron bashkia në fushën e:</p> <ul style="list-style-type: none"> • infrastrukturës dhe shërbimeve publike; e shërbimeve sociale; e kulturës, sportit dhe 		<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transpareanca/vendi-me-te-keshillit-bashkiak-diber/sherbimet-administrative-sipas-7-funkstioneve/</p>	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë	Kordinatori për të Drejtën e Informimit

<p>shërbimeve argëtuese; e mbrojtjes së mjedisit; e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kulturave publike, natyrës dhe biodiversitetit; e zhvillimit ekonomik vendor, e sigurisë publike</p> <p>funksiioneve dhe kompetencave të deleguara</p> <p>Për çdo shërbim (por pa u kufizuar) informacion përshterues mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Strukturat përgjegjëse, adresën dhe orarin e punës • Procedurat që duhen ndjekur për të përfunduar shërbime administrative • Tarifat për shërbimet administrative • Rregullat për mënyrën e kryerjes së pagesës • Subjektet që përfshihen nga tarifa 		<p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>			
<p>Kontratat publike.</p> <p>Përshim bëjten publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Objektivit, numrit të referencës, llojit të procedurës, termave dhe kushteve të kontratës, kohëzgjatjes dhe vlerës së kontratës, • Dhënave të autoritetit kontraktor • Treguesve për majten e përmbljes së kontratës • Strukturave publike përgjegjëse për mbikqyrjen dhe monitorimin e kontratës • Procedurave që duhet ndjekur për të bërë një ankimim • Raporteve të kontrollit, monitorimit dhe auditimit mbi zbatimin e kontratës 	<p>Neni 7/ i ligjit nr. 119/2014 si dhe neni 25 dhe 71, i VKM nr.914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparenca/vendi-me-te-keshillit-bashkiak-diber/kontratat-publike/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>Publikimi brenda 5 (pesë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>
<p>E drejta e aksesës dhe vërejtjes në lidhje me shërbimet</p> <p>Përshim bëjten publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Procedurave për të bërë ankesa apo vërejtje në lidhje me shërbimet • Adresës postare dhe elektronike për depozitimin e ankesave apo vërejtjeve 		<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparenca/vendi-me-te-keshillit-bashkiak-diber/e-drejta-e-akseses-dhe-verejtes-ne-lidhje-me-sherbimet/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	<p>Brenda 10 ditëve nga sipallja e miratimit</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Koordinatori për të Drejtën e Informimit</p>

Fusha 5 - Legjislatoni dhe aktet e brendshme rregullatore

Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Referenca ligjore	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikim
1.	Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore 1 organizuar (jo i detyrueshëm) sipas fushave: <ul style="list-style-type: none"> Fusha e organizimit dhe funksionimit të bashkisë Fusha e veprimtarisë ekonomiko-financiare Fusha e qeverisjes së mirë vendor (integriteti, etika, anti-korrupsioni, transparencë, llogaridhënia etj) Fusha e infrastrukturës dhe shërbimeve publike Fusha e shërbimeve sociale Fusha e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuuese Fusha e mbrojtjes së mjedisit Fusha e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit Fusha e zhvillimit ekonomik vendor Fusha e sigurisë publike Fusha e funksioneve dhe kompetencave të deleguara Çdo fushë duhet të përmbajë: <ul style="list-style-type: none"> Aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse Dokumentet politike kombëtar përkatës Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e këshillit të bashkisë me karakter normativ Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e kryetarit të bashkisë me karakter normativ Dokumentet politike vendor 	Neni 7/b i ligjit nr. 119/2014	Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparencat/legjislativoni-dhe-aktet-e-brendshme-rregullatore/	Mënjëherë pas botimit në faqen zyrtare.	Kuvendi i Shqipërisë Këshilli i Ministrave Ministri	Kordinatori për të Drejtën e Informimit

Fusha 6 - Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje

Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Referenca ligjore	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikim
1.	Të dhënat e kordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik. Përshin bërjen publike të: <ul style="list-style-type: none"> Emrit mbiemrit të Koordinatorit Adresës postare/elektronike të tij 	Neni 16/2 i ligjit nr.139/2015 dhe neni 10 i ligjit nr.146/2014	Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparencat/pjesemarrja-qytetare-ne-vendimmarrje/	Mënjëherë pas miratimit të urdhërit të caktimit të kordinatorit	Kryetari i Bashkisë	Kordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

	<ul style="list-style-type: none"> Orarit të punës 			Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative				
2.	<p>Plani vjetor për procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrje. Përfishin bëjten publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> Akteve që do të konsultohen Mënyrat e konsultimit Afatei Strukturat përgjegjëse 	Neni 6/b i ligjit nr.146/2014	Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparencja/pjesemarrja-qytetare-me-vendimmarrje/plani-vjetor-per-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjesemarrje/	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit	Këshilli i Bashkisë Kryetari i Bashkisë	Sekretari i Këshillit të Bashkisë Kordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik		
3.	<p>Dispozitat e brendshme rregullatorë për këshillimin me publikum. Përfishin bëjten publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> Procedurave, afateve dhe mënyrat e organizimit për çdo formë/lloj konsultimi Strukturat përgjegjëse për aktet e detyrueshme për konsultim 	Neni 18/2 i ligjit nr.139/2015 dhe neni 6 i ligjit nr.146/2014	Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparencja/pjesemarrja-qytetare-me-vendimmarrje/dispozitat-e-brendshme-rregullatore-per-keshillim/	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit	Këshilli i Bashkisë Kryetari i Bashkisë	Sekretari i Këshillit të Bashkisë Kordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik		
4.	<p>Akte për të cilët është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik. Përfishin bëjten publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> Listës së akteve për të cilët është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik 	Neni 18/1, i ligjit nr. 139/2015 Neni 5/ç dhe 13/3 i ligjit nr.68/2017 Neni 1/1 dhe 4/c e ligjit 146/2014	Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparencja/pjesemarrja-qytetare-me-vendimmarrje/aktet-per-te-cilet-eshte-e-detyrueshme-zhvillimi-i-konsultimit/	Menjëherë	Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik	Sekretari i Këshillit të Bashkisë Kordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik		

			njoftim publik dhe Njësitë Administrative			
5.	<p>Njoftimi për nisjen e vendimmarrjes me pjesëmarrje</p> <p>Përshin bëjten publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> Projektit, relacionin shpjegues dhe dokumentave shoqërues të tij, Arsyeve të nevojshme për nxjerrjen e projektaktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë Afati, vendi dhe mënyrën me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre; Adresën e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik të bashkisë ose të strukturës përgjegjëse për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin; Vendi dhe datën e organizimit të takimit publik në rastet kur bashkia vendos për organizimin e tij 	Neni 11, 13 dhe 14 i ligjit nr.146/2014	Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparenca/pjesemarrja-qytetare-me-vendimmarrje/njoftimi-per-nisjen-vendimmarrse-me-pjesemarrje/	Menjëherë	Këshilli i Bashkisë Kryetari i Bashkisë	Sekretari i Këshillit të Bashkisë Kordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik
6.	<p>Procedura e marrjes dhe shqyrtimi të komenteve dhe rekomandimeve.</p> <p>Përshin bëjten publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> Adresën postare/ elektronike për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve Afatin për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve Mënyrën mbajtjes së procesverbalit dhe regjistrimit të takimit publik për takimet publike Mënyrën e trajtimit të komenteve dhe rekomandimeve Mënyrën e dhënies së arsyeve për mospranimin komenteve dhe rekomandimeve 	Neni 15 i ligjit nr.146/2014	Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparenca/pjesemarrja-qytetare-me-vendimmarrje/procedurat-e-marrjes-dhe-shqyrtimi-te-komenteve-dhe-rekomandimeve/	Menjëherë	Këshilli i Bashkisë	Sekretari i Këshillit të Bashkisë Kordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

7.	<p>Procedurat që duhen ndjekur për të bërë një ankim në lidhje me konsultimin publik.</p> <p>Përshin bëjten publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Subjektet ku mund të bëhet ankesa (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Këshilli i bashkisë, Kryetari i bashkisë;) • Adresën postare/ elektronike për dërgimin e ankesës • Procedurat për të bërë një ankesë në lidhje me keshillimin me publikun • Struktura përgjegjëse në nivel bashkie që regjistron dhe shqyrton ankesën 	Neni 21 i ligjit nr.146/2014	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparencia/pjesemaria-gyjetare-ne-vendimmarje/procedurat-e-ankimit-lidhur-me-procesin-e-keshillimit/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	Menjëherë	Këshilli i Bashkisë	Sekretari i Këshillit Bashkiak
8.	<p>Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarjes.</p> <p>Përshin bëjten publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Numri të akteve të miratuara nga organet e bashkisë me konsultim publik gjatë një viti. • Numrin e përgjithshëm të komenteve dhe rekomandimeve të marra nga palët e interesuara; • Numrin e rekomandimeve dhe komenteve të pranuarra dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarjes • Numrin e takimeve publike të organizuara 	Neni 20/1 i ligjit nr.146/2014	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparencia/pjesemaria-gyjetare-ne-vendimmarje/raporti-vjetor-per-transparencen-procesin-e-vendimmarjes/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit	Këshilli i Bashkisë	Sekretari i Këshillit të Bashkisë
9.	<p>Iniciativa qytetare.</p> <p>Përshin bëjten publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mënyrës dhe formës së paraqitjes së iniciativës qytetare • Procedurave të shqyrtimit dhe e miratimit të iniciativës qytetare • Adresës postare/elektronike për depozitimin e iniciativës qytetare. • Mënyrat dhe afatet e kthimit të përgjigjeve për mos miratimin e iniciativës qytetare 	Neni 20/1, i ligjit nr.139/2015	<p>Në faqen zyrtare të internetit, http://dibra.gov.al/transparencia/pjesemaria-gyjetare-ne-vendimmarje/iniciativa-gyjetare/</p> <p>Në vendet e caktuara për njoftim publik dhe Njësitë Administrative</p>	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit	Këshilli i Bashkisë	Sekretari i Këshillit të Bashkisë

Fusha 7 - Informacion tjetër

Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Referenca ligjore	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin
-----	---	-------------------	---	--------------------------	-----------------	----------------------------------